



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2018:008663
Datë: 02.05.2018
Numri i dokumentit: 00032258

P. nr.295/18

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjykatëses së vetme gjykuese, *Luljete Shabani*, në lëndën penale kundër të akuzuarve *B.N.*, të cilin sipas detyrës zyrtare e mbronë av. *G.S. dhe M.M.*, të cilin, sipas detyrës zyrtare e mbronë av. *H.L.*, për veprën penale, *Pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare*, nga neni 409 paragrafi 5 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm PP.II nr.372/2018, të datës 19.03.2018, e sipas marrëveshjes për pranimin e fajsisë, të datës 23.03.2018, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar publik, më datën 30.03.2018, mori dhe në prezencë të palëve shpalli, dhe më datë 27.04.2018 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit:

1. *B.N.*, nga babai *J. dhe nëna S.*, e lindur *M.*, i lindur më datë ... në Gjilan, me vendbanim në fsh. ..., *K. e ...*, i pamartuar, i papunë, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së dobët ekonomike, Sërb, shtetas i Republikës së Kosovës, i dënuar më parë dhe nuk udhëhiqet procedurë tjetër penale,
2. *M.M.*, nga babai *V. dhe nëna S.*, e lindur *S.*, i lindur më datë ... në Gjilan, me vendbanim në fsh. ..., *K. e ...*, i pamartuar, i papunë, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së dobët ekonomike, Sërb, shtetas i Republikës së Kosovës, i dënuar më parë dhe nuk udhëhiqet procedurë tjetër penale

JANË F A J T O R Ë

Sepse, më datë 07.03.2018, rreth orës 02.15 minuta, në fsh. *Pasjan*, *K. e Parteshit*, me dashje e kanë penguar personin zyrtar në kryerjen e detyrës zyrtare, konkretisht, zyrtarin policor, *I.P.*, në atë mënyrë që pas një mosmarrëveshje lidhur me parkimin e veturës, fillimisht i kanë fyer me fjalë ofenduese, duke i quajtur policët “Analfabetë, budallë” dhe kur zyrtari policor me ndihmën edhe të kolegëve të vet kanë tentuar t’i vënë nën kontroll, të njejtit e kanë penguar edhe fizikisht, duke e shtyer me duar, me çka, me veprimet e tyre kanë penguar personin zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare ,

*-me çka ka kryer veprën penale, **Pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zrtare, nga neni 409 paragrafi 5 të KPRK-së, andaj, Gjykata, bazuar në dispozitat e neneve 7,17,21,51,73,114,të KPRK-ës, dhe nenit 365, 453 dhe 463 të KPPRK-së,***

I GJYKON

Të akuzuarin B.N., me Dënim me Burg, në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, ashtu që, në mbështetje të nenit 47 të KPRK-së, me pëlqimin e të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij, av. G.S., dënimi i shqiptuar me burg, do t'i zëvendësohet në Dënim Gjore, në shumë prej 1600 (njëmijë e gjashtëqind) €, të cilin dënim i akuzuari është i obliguar ta paguajë në afatin prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi.

Në dënimin e shqiptuar, do t'i llogaritet edhe koha e kaluar në arrest shtëpiak prej dt.07.03.2018 deri më dt.30.03.2018, me ç'rast, do t'i mbeten për t'i paguar gjobën prej 1000 (një mijë) €

Në bazë të nenit 39 par.4 nënpar. 3.1 të Ligjit për kompensimin e viktimave të krimit, të akuzuarit shqiptohet taksa në shumën prej 30 (tridhjetë) €

Obligohet i akuzuari që ti paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe paushallin gjyqësor në lartësi prej 20 (njëzet) €, te gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi.

Të akuzuarin M.M., me Dënim me Burg, në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, ashtu që, në mbështetje të nenit 47 të KPRK-së, me pëlqimin e të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij, av. H.L., dënimi i shqiptuar me burg, do t'i zëvendësohet në Dënim Gjore, në shumë prej 1600 (njëmijë e gjashtëqind) €, të cilin dënim i akuzuari është i obliguar ta paguajë në afatin prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi.

Në dënimin e shqiptuar, do t'i llogaritet edhe koha e kaluar në arrest shtëpiak prej dt.07.03.2018 deri më dt.30.03.2018 me ç'rast, do t'i mbeten për t'i paguar gjobën prej 1000 (një mijë) €

Në bazë të nenit 39 par.4 nënpar. 3.1 të Ligjit për kompensimin e viktimave të krimit, të akuzuarit shqiptohet taksa në shumën prej 30 (tridhjetë) €

Obligohet i akuzuari që ti paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe paushallin gjyqësor në lartësi prej 20 (njëzet) €, te gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi.

I dëmtuari për kompensimin e demit material, udhëzohet në kontest civil.

A r s y e t i m

*Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, ka paraqitur Aktakuzën PP.II nr. 372/2018, të datës 19.03.2018, kundër të akuzuarve B.N. dhe M.M., për veprën penale, **Pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zrtare, nga neni 409 paragrafi 5 të KPRK-së dhe ka kërkuar që të akuzuarit të shpallen fajtorë dhe të dënohen me dënim meritor sipas ligjit.***

Prokurorja e Prokurorisë Themelore, Departamenti i Përgjithshëm në Gjilan, përmes prokurores së shtetit Kujtesa Fazliu, kanë arritur marrëveshje mbi pranimin e fajësisë me të pandehurit B.N. dhe mbrojtësit të tij, av. G.S. dhe të akuzuarin M.M. dhe mbrojtësit të tij, av. H.L.

Prokurorja e shtetit në seancën e shqyrtimit fillestar lidhur me pranimin e fajësisë të mbajtur më datë 30.03.2018, deklaroi se për një gjë të tillë kanë pasur autorizim edhe nga Kryeprokurori dhe këtë marrëveshje mbi pranimin e fajësisë e kanë nënshkruar së bashku duke përfshirë këtu Kryeprokurorin, të pandehurit, mbrojtësit e tyre dhe prokurorja në fjalë, andaj, kërkojmë nga gjykata që ta pranojë marrëveshjen me nr. PP.II.nr. 372/2018 të datës 23.03.2018.

Mbrojtësit e të pandehurve, av. G.S. dhe H.L., deklaruan se mbeten pranë marrëveshjes për pranimin e fajësisë, gjithashtu kërkon nga gjykata që ta pranojë këtë marrëveshje.

Të akuzuarit B.N. dhe M.M., deklaruan se marrëveshjen për pranimin e fajësisë e kanë nënshkruar në mënyrë vullnetare, të vetëdijshëm se çka përmban e njëjta, paraprakisht janë konsultuar me mbrojtësit e tyre, janë penduar për kryerjen e kësaj vepre penale ndërsa nuk kanë qenë të kërcënuar apo mashtruar për ta nënshkruar këtë marrëveshje, andaj edhe këta kërkojnë nga kjo gjykatë që ta pranojë këtë marrëveshje.

Gjykata në seancën e shqyrtimit fillestar lidhur me pranimin e fajësisë, mori aktvendim me të cilin e pranoi marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë, dhe i njoftoi palët se pasi që marrëveshja mbi pranimin e fajësisë është arritur me vetëdije të plotë dhe vullnet të lirë, nuk i lejohet të pandehurit dhe mbrojtëses së tij, e as prokurorit të shtetit që të tërhiqen nga kjo marrëveshje mbi pranimin e fajësisë pasi që janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore të parapara në nenin 233 par. 18 të KPRK-së.

Me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, Gjykata pati parasysh rrethanat e parapara me nenin 73 të KPRK-së, dhe si rrethanë lehtësuese gjeti se të akuzuarit patën sjellje korrekte në Gjykatë, se janë penduar për veprën në fjalë, ndërsa, si rrethanë rënduese, rrezikshmërinë e veprës penale, e cila është kryer ndaj personit zyrtar, me bindje se një dënim të tillë është në përputhshmëri me shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarve dhe rrezikshmërinë shoqërore të veprës, duke qenë e bindur se edhe me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit si në kuptim të nenit 41 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është i bazuar në nenin 453 të KPPRK -së.

Nga të cekurat më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykim

DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL

2018:008663, 27.04.2018

G j y q t a r i

Luljete Shabani

KËSHILLA JURIDIKE: Palët kanë hequr dorë nga ankesa kundër këtij aktgjykim